

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7825
E mërkurë, 3 korrik 2024
Çmimi 0.50 €

Osmani: Heqja e masave të BE-së e bën të barabartë dialogun në Bruksel

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:


www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

IKD-ja: QEVERIA MIRATOI LIGJE NË KUNDËRSHTIM ME KUSHTETUTËN DHE REALIZOI VETËM 15 % TË AGJENDËS LEGJISLATIVE

FAQE 4-5



Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), gjatë monitorimit të zbatimit të programit legjislativ brenda programit "Qeverisja e Mirë", ka

theksuar se qeveria miratoi ligje në kundërshtim me Kushtetutën, shkeli aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese, mori vendime pa

konsultime të mjaftueshme publike dhe realizoi vetëm 15 % të agjendës legjislative të planifikuar për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024

ALEATËT NË AKSION: BE-ja DHE NATO-ja 'TË ANGAZHohen BASHKËRISHT' PËR KOSOVËN

F. 4



34 VJET NGA DEKLARATA KUSHTETUESE E 2 KORRIKUT, DEPUTETËT TREGOJNË SE PËR DY MUJ ISHTE PUNUAR VETËM NATËN DHE NË MËNYRË ILEGALE

F. 5



AKTUALE



KOSOVA, DITË ZIE NË NDERIM TË KADARESË F. 3

GËRVALLA DHE ZUPANÇIQI RIAFIRMOUAN PËRKUSHTIMIN PËR TA THELLUAR BASHKËPUNIMIN KOSOVË - SLOVENI F. 3

KASTRATI URON BUJOIT MALISHEVAS PËR FILLIMIN E KORRJES SË GRURIT F. 6

EKONOMI



ODA EKONOMIKE AMERIKANE NDAU ÇMIMET E PARTNERITETIT SHBA - KOSOVË F. 8

AIP KËRKON NGA NDËRMARRJET PUBLIKE DHE PRIVATE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE TË QYTETARËVE F. 8

SPORT



XHAKA: ITALINË E MPOSITËM ENDE PA ZBRITUR NË FUSHË F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Hilli: Nuk e kuptoj pse u ndalua festivali 'Mirëdita, Dobar dan'

BEOGRAD, 2 KORRIK - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Serbi, Christopher Hill, tha se nuk e kupton vendimin për ndalimin e festivalit "Mirëdita, Dobar dan" sepse, siç tha, është një ngjarje që e inkurajon bashkëpunimin në mes të Serbisë dhe Kosovës. Hill tha në një intervistë për revistën "Diplomacy and Commerce" se nuk e priste një vendim të tillë nga autoritetet serbe, transmeton Shërbimi i Ballkanit i "Radios Evropa e Lirë". "Ka gjithmonë arsye të sigurisë, kjo është e qartë për mua. Por, unë nuk e kuptoj këtë vendim. Festivali ka qenë i shkëlqyeshëm për Serbinë, është mbajtur për dhjetë vjet...", tha Hill.

Ai kujtoi se festivali është sponsorizuar nga Bashkimi Evropian dhe tha se BE-ja po përpqet t'i normalizojë marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Kjo do të thotë, para së gjithash, ulje e tensioneve, por nënkupton edhe ide për bashkëpunim të ndërsjellë", tha ambasadori amerikan. Mungesa e normalizimit të marrëdhënies, sipas tij, "do të thotë jostabilitet, do të thotë probleme". "Ndërsa evropianët duan ta shohin Serbinë në mesin e tyre, brenda strukturave të tyre, ata duan që Serbia t'i zgjidhë ose të paktën t'i adresojë problemet e saj përpara se të hyjë në BE. Pra, unë mendoj se ata janë shumë të përqendruar në

normalizim, ashtu sikurse edhe ne", tha Hill.

Festivali "Mirëdita, Dobar dan", i cili promovon bashkëpunimin mes skenës kulturore e artistike të Kosovës dhe asaj të Serbisë, është dashur të mbahet në Beograd nga data 27 deri më 29 qershor.

Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë ndaloi mbajtjen e tij, për shkak të, siç tha, "rrezikimit të sigurisë së njerëzve dhe pronës", pas tubimit të ultra të djathtëve që e kundërshtuan mbajtjen e festivalit.

Ndalimi i festivalit u dënua nga organizatat joqeveritare në rajon dhe nga disa parti opozitare në Serbi, ndërsa Bashkimi Evropian shprehu keqardhje.



Bazat amerikane në Evropë përgatiten për sulm të mundshëm terrorist



UASHINGTON, 2 KORRIK - Bazat ushtarake dhe personeli amerikan në të gjithë Evropën u vunë në gatishmëri të shtuar, pasi informacionet e reja të inteligjencës paralajmëruan për një sulm të mundshëm terrorist. Një zyrtar i mbrojtjes amerikane konfirmoi për Zërin e Amerikës se objektet ushtarake në të gjithë Komandën Evropiane të ShBA-së (EUCOM) u ngritën në shkallën "Charlie" të mbrojtjes, që do të thotë se një sulm është i mundur.

Zyrtari nuk dha detaje për përmbajtjen e informacioneve të inteligjencës, por zyrtarë që

merren me antiterrorizmin nga shumë vende paralajmëruan për kërcënime në rritje, përfshirë edhe ato që lidhen me Olimpiadën e ardhshme Verore në Paris.

Në njoftimin e EUCOM-it thuhet se masat e shtuara të sigurisë janë rezultat i një kombinimi faktorësh. "Rritja e gatishmërisë nuk lidhet me ndonjë kërcënim specifik, por me disa faktorë të kombinuar, siç janë ngjarjet e mëdha - përfshirë këtu Kampionatin Evropian të Futbollit dhe Lojërat Olimpikë - dhe sulmet e mundshme nga individë të këqij kundër

objektivave të ndryshme joushtarake në Evropë", thuhet në deklaratë.

EUCOM-i e këshilloi personelin në Evropë që "të tregojë kujdes në çdo kohë, të raportojë aktivitetet të dyshimta, t'i ndjekë këshillat për udhëtim që i jep Departamenti i Shtetit dhe të ndërmarrë masa të shtuara për zbutjen e rrezikut personal". Zyrtari amerikan i mbrojtjes tha se ushtria "po ndërmerr hapa shtesë për t'u siguruar që trupat amerikane të jenë të kujdesshme si gjatë aktiviteteve të punës, ashtu edhe gjatë aktiviteteve personale".

Blinken: Të vendosur për ta parandaluar përsëritjen e konfliktit Izrael -Hezbollah

UASHINGTON, 2 KORRIK - Shtetet e Bashkuara janë të vendosura për të parandaluar që konflikti ushtarak midis Izraelit dhe luftëtarëve të Hezbollahut me bazë në Libanin jugor të përsëritet në një luftë gjithëpërfshirëse, tha të hënën sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, para një auditori në Institutin Brookings me qendër në Uashington. Sipas sekretarit Blinken, "asnjë nga aktorët kryesorë në të vërtetë nuk dëshiron luftë". "Unë nuk besoj se Hezbollahu në të vërtetë dëshiron luftë. Izraeli nuk dëshiron luftë, megjithëse mund të jetë i përgatitur të përfshihet në një të tillë nëse është e nevojshme. Libani sigurisht që nuk dëshiron luftë, sepse do të ishte viktima kryesore në një luftë

të tillë", shtoi ai. "Po ashtu, nuk besoj se Irani dëshiron luftë sepse nuk do që Hezbollahu të shkatërohet dhe sepse mund të synojë ta mbajë Hezbollahun si "kartë" nëse do i nevojitet". Ndërsa Blinkeni mbante fjalën, përmes mikrofonit të tij mund të dëgjoheshin protestuesit pro-palestinez jashtë Institutit Brookings. Sekretari Blinken përsëriti thirrjen drejtuar kreut të Hamasit në Gazë, Yahya Sinwar, për ta pranuar armëpushimin e propozuar nga ShBA-ja dhe nënvizoi nevojën për një plan të mirëpërgatitur për Gazën pas luftës. "Kur konflikti të përfundojë duhet të ketë plane të qarta dhe të arritshme për qeverisjen në Gazë, për sigurinë e saj dhe natyrisht për t'i ndihmuar

njerëzit që t'i rindërtojnë jetët e tyre, të cilat janë shkatërruar", tha ai.

Në fjalimin e tij për politikën e jashtme Blinkeni foli edhe për Kinën. "Unë mendoj se objektivat e Kinës janë të qarta. Me kalimin e kohës, gjatë dekadave të ardhshme, Kina synon të jetë vend udhëheqës, dominues në arenën ndërkombëtare, ushtarakisht, ekonomikisht, diplomatikisht. Kjo është e qartë", tha ai.

Ndërsa Shtetet e Bashkuara kanë deklaruar se qëllimi i tyre është ta menaxhojë me përgjegjësi konkurrencën me Kinën, Pekini e ka hedhur poshtë një gjë të tillë, duke thënë se marrëdhënia midis dy ekonomive më të mëdha në botë nuk duhet të përcaktohet nga konkurrenca.



Gërvalla dhe Zupançiqi riafirmuan përkushtimin për ta thelluar bashkëpunimin Kosovë - Slloveni


Prishtinë, 2 korrik - Zgjerimi i bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët, mbështetja e Republikës së Kosovës në rrugën e integritit euroatlantik dhe anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, siguria në rajon dhe bashkëpunimi në iniciativa rajonale që për qëllim kanë ruajtjen e paqes dhe stabilitetit, ishin temat në fokus të takimit në mes të zëvendës-kryeministres, ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla dhe

kryetares së Parlamentit të Sllovenisë, Urshka Klakoçar-Zupançiq, në kuadër të vizitës së saj zyrtare në Kosovë. Gjatë këtij takimi ministrja Gërvalla e falënderoi kryetaren e Parlamentit të Sllovenisë, Urshka Klakoçar-Zupançiq, për mbështetjen që deputetët sllovenë i kanë dhënë Republikës së Kosovës në procesin e anëtarësimit në Këshillin e Evropës, përkatësisht mbështetjen në arritjen e 82 % të votës pro anëtarësimit nga Asambleja Parlamentare e KiE.

Ministrja Gërvalla në takim me kryeparlamentaren sllovene paraqiti të arriturat e Republikës së Kosovës në shumë fusha dhe mundësitë e mëdha të investimeve në vendin tonë, duke theksuar potencialin e madh të të rinjve. Më tej ministrja Gërvalla dhe kryetarja Zupançiq riafirmuan përkushtimin e tyre për ta thelluar më tej bashkëpunimin bilateral dhe për të eksploruar mundësi të reja që do të sjellin përfitime konkrete për qytetarët e të dy vendeve.



Osmani: Heqja e masave të BE-së e bën të barabartë dialogun në Bruksel

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 KORRIK - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë, gjatë një takimi me ambasadorin amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, se heqja e masave ndëshkuese të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës do ta kishte bërë të "barabartë tryezën e dialogut" në Bruksel.

Osmani pati takim të rregullt me Hovenierin në zyrën e saj në Prishtinë, njoftoi Presidenca e Kosovës. "Në takim është diskutuar për zhvillimet e fundit në vend, përfshirë zhvillimet në dialogun

me Serbinë. Në këtë drejtim, Presidentja Osmani ritheksoi rëndësinë e largimit të masave për të krijuar një situatë të barabartë në tryezën e dialogut. Tutje, presidentja Osmani dhe ambasadori Hovenier diskutuan edhe për koordinimin e agjendës ndërkombëtare të presidentes Osmani. Në prag të 4 Korrikut, Ditës së Pavarësisë së ShBA-ve, presidentja përcolli urimet më të mira për popullin amerikan, duke rikonfirmuar përkushtimin e Kosovës për forcimin e vazhdueshëm të aleancës me Shtetet e Bashkuara", thuhet në njoftimin për medie.

Kosova ka masa ndëshkuese të Bashkimit Evropian që prej verës së vitit 2023, të cilat blloku i vendosi si përgjigje ndaj përshkallëzimit të situatës së sigurisë në veri të Kosovës, kur kryetarët shqiptarë, të dalë nga zgjedhjet që u bojkotuan nga serbët lokalë, nisën detyrën e tyre në komunat në veri. Më 19 qershor në Komitetin për Politikë dhe Siguri të BE-së (PSC), ku morën pjesë përfaqësuesit e shteteve anëtare, u diskutua për heqjen e masave kundër Kosovës. Shumica e shteteve të BE-së ishin në favor të heqjes së plotë të masave, siç edhe ka rekomanduar përfaqësuesi i lartë i bllokut për

politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, në raportin që u dorëzoi vendeve anëtare më 18 qershor, lidhur me hapat që Kosova ka ndërmarrë për uljen e tensioneve në veriun e banuar me shumicë serbe.

Ndër masat e BE-së janë suspendimi i përkohësisht i punës së trupave të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Kosova, po ashtu, nuk ftohet në ngjarjet e nivelit të lartë dhe vizitat bilaterale janë suspenduar, përveç atyre që fokusohen në adresimin e krizës në veri të Kosovës në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja. Propozimet e dorëzuara nga

Kosova në kuadër të Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF) nuk janë paraqitur për shqyrtim në bordin e këtij fondi. Kontratat e reja ku autoritetet e Kosovës janë përfituese tash për tash janë të ndalura.

Autoritetet në Kosovë disa herë kanë insistuar se kanë përmbushur kërkesat për heqjen e masave dhe se situata në veri të Kosovës është shtensionuar, serbët e Kosovës kanë pasur mundësi të votojnë për shkarkimin e kryetarëve të komunave dhe tash, sipas tyre, nuk ka më arsye që të mbahen këto masa.

Kosova, ditë zie në nderim të Kadaresë

PRISHTINË, 2 KORRIK - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, në mbështetje të Kushtetutës së Kosovës, ka marrë vendim që dita e mërkurë, 3 korrik 2024, të shpallet ditë zie shtetërore në nderim të kolosit të letrave shqipe, shkrimtarit shqiptar me famë botërore, të ndjerit Ismail Kadare.

Zija shtetërore do të jetë gjatë ditës së mërkurë, ditën kur edhe varroset i ndjeri Ismail Kadare, ndërkaq Protokolli i Shtetit ngarkohet që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Presidentja Osmani në qershor të vitit të kaluar e ka dekoruar shkrimtarin Ismail

Kadare me Urdhrin "Hasan Prishtina", ndër Urdhrrat më të lartë të cilin e jep Republika e Kosovës për personalitetet më të shquara të kombit. Ndërsa në gusht presidentja shpalli dekretin me të cilin shkrimtarit shqiptar me famë botërore, Ismail Kadare, i është dhënë nënshpëtimet e Republikës së Kosovës.





ALEATËT NË AKSION: BE-JA DHE NATO-JA 'TË ANGAZHohen BASHKËRISHT' PËR KOSOVËN

Për Kosovën dhe Serbinë, normalizimi i marrëdhënieve është kusht për të përparuar në rrugën e anëtarësimit në BE

PRISHTINË, 2 KORRIK - Në vitin 2013, kur Kosova dhe Serbia arritën marrëveshjen e parë për normalizimin e marrëdhënieve, pritjet ishin që ajo të silte frymë të re mes dy vendeve armiqësore, t'i trajtonte ndarjet etnike në Kosovë dhe t'i hapte rrugë integrimit më të madh ndërkombëtar të shtetit - atëkohë vetëm 5 vjeç. Udhëheqës të negociatave ishin Hashim Thaçi, kryeministër i Kosovës, dhe Ivica Dačić, kryeministër i Serbisë. Ajo që i uli bashkë në tryezë dhe arriti t'i përfaqësojë qëndrimet mes tyre pas gjashtë muajsh bisedime, ishte Catherine Ashton, atëkohë shefe e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian. "Negociatat përfunduan. Teksti [i marrëveshjes] u nënshkrua nga të dy kryeministrat. Dua t'i përgëzoj për vendosmërinë gjatë këtyre muajve dhe për guximin që kanë", tha Ashton në prill të 2013-s. Marrëveshja nuk u zbatua kurrë në tërësi prej asnjë palë dhe ato fajësuan vazhdimisht njëra-tjetrën për dështime. Ashton u zëvendësua në vitin 2014 nga Federica Mogherini, e cila ndërmjetësoi disa raunde negociatash në mes të Kosovës dhe Serbisë, por dëshmoi edhe valë të reja të tensioneve mes tyre. Në vitin 2019 pozitën e shefit të politikës së jashtme të BE-së e mori Josep Borrell, në mandatin e të cilit Kosova dhe Serbia arritën edhe një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve në vitin 2023, por që, njësoj, nuk u zbatua. Përkundër përpjekjeve javën e kaluar, Borrelli nuk arriti t'i ulte

bashkë në tryezë kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentin e Serbisë, Aleksandar Vučić, për shkak të, siç tha, disa kushteve që nxori Kurti, e që Vučići nuk i pranoi. Për të dyja vendet normalizimi i marrëdhënieve është kusht për të përparuar në rrugën e anëtarësimit në BE. Aktualisht, të dyja ato janë në vendndalim: Kosova nuk ka marrë asnjë përgjigje për aplikimin për anëtarësim, të bërë qysh në fund të vitit 2022, ndërsa Serbia, nga viti 2021, nuk ka hapur asnjë kapitull të negociatave për praninë. Ndërmjetëso mes tyre, nga vjeshta, do të jetë Kaja Kallas, e cila do të konfirmohet në pozitën e shefes së politikës së jashtme të BE-së për pesë vjetet e ardhshëm. Kallas, aktualisht kryeministre e Estonisë, është shprehur pro integrimit evropian të Kosovës dhe ka theksuar, po ashtu, nevojën e përmirësimit të marrëdhënieve me Serbinë, duke thënë se një Ballkan Perëndimor i sigurt "është në interesin e gjithë Evropës". Për vëzhguesit e dialogut Kosovë - Serbi, Kallas do të duhej ta ndryshonte taktikën e ndërmjetësimit mes dy vendeve. Kushtëzimi me vetëm integrimin evropian nuk ka bërë punë, thotë për programin "Expose" të "Radios Evropa e Lirë", Maja Pishqeviq nga Këshilli Atlantik. "Instrumenti i fuqishëm financiar do të ishte një nga mënyrat - pra ndalimi i mbështetjes financiare nga Bashkimi Evropian, e cila është shumë e rëndësishme për të gjitha

vendet e Ballkanit Perëndimor. Edhe pse ato ankojnë se ajo nuk është e mjaftueshme, do të ishte shumë e rëndë për secilin prej vendeve nëse do të mbetej pa të", thotë Pishqeviq. Bashkimi Evropian planifikon ndarjen e një fondi prej 6 miliardë eurosh për vendet e Ballkanit Perëndimor për periudhën 2024-2027, me qëllim përshtetimin e integrimit evropian të tyre. Gjatë një vizite në Prishtinë dhe në Beograd, më 18 dhe 19 qershor, i dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Mirsollav Lajçak, i cili, po ashtu, do të zëvendësohet në muajt e ardhshëm, paralajmëroi se Kosova dhe Serbia duhet të dëshmojnë qasje konstruktive në dialog për të pasur qasje në këtë fond. Pishqeviq thotë se kjo është e domosdoshme të zbatohet në praktikë sa më parë që të jetë e mundur. "Kushdo që e zëvendëson Lajçakun duhet të ketë instrumente të tjera për ta drejtuar procesin. Nëse nuk i ka, do të përfundojë si Lajçaku [pa i bindur palët për t'i zbatuar marrëveshjet]. Nuk jam optimiste se do të ndryshojë ndonjë gjë, nëse vetëm emrat [e ndërmjetësuesve] ndryshojnë", thotë Pishqeviq. Marrë parasysh "status quo-në e brishtë" në Kosovë, Pishqeviqi shton se BE-ja do të duhej të koordinohet edhe me partnerë ndërkombëtarë, të tillë si NATO-ja, për ta mbështetur procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë.

NATO-ja, me misionin e saj paqeruajtës KFOR, është e pranishme në Kosovë që nga fundi i luftës më 1999. Nën vëzhgimin e saj, shtatorin e kaluar ndodhi një sulm i armatosur në fshatin Banjskë - pjesa veriore e Kosovës - ku grupe të armatosura të serbëve sulmuan policinë e Kosovës, duke vrarë një polic dhe duke rritur shqetësime për sigurinë rajonale. Vetëm pak muaj para atij sulmi, po në veri të Kosovës, grupe serbësh u përleshën me pjesëtarë të KFOR-it, në protestat kundër kryetarëve shqiptarë në komunat me shumicë serbe. Javën e kaluar në krye të aleancës ushtarake u emërua sekretari i ri i përgjithshëm, Mark Rutte. Rutte, i cili për 14 vjet shërbeu kryeministër i Holandës, është i njoftuar nga afër për situatën në Kosovë. Ai zhvilloi disa takime me udhëheqësit aktualë - të fundit me presidenten Vjosa Osmani më 17 qershor, në margjinat të një samiti për Ukrainën. Verën e kaluar ai ishte personalisht në Kosovë, duke bërë thirrje për ulje të tensioneve, pas disa incidenteve në veriun e banuar me shumicë serbe. Jamie Shea, ish-zëvendës i ndihmësit të sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, thotë për "Exposën" se gjëja e parë që do të duhej të bëjë Rutte në Kosovë, është ta forcojë misionin e KFOR-it në kufirin e saj me Serbinë. "Pas incidentit në Banjskë, vitin e kaluar, kur paraushtarakët serbë kanë depërtuar në Kosovë dhe kanë shkaktuar kaos, është parë

mungesa e sigurisë në kufi. Ka qenë e lehtë për ta të fusin armë dhe personel. KFOR-i është forcuar pastaj me ushtarë nga Turqia, Britania, Gjermania... por duhet të jetë edhe më i dukshëm në veri dhe të patullojë në kufi", thotë Shea. Ai shpreh bindjen se Rutte, si shef i NATO-s, do ta mbajë Kosovën lart në agjendë, pikërisht për shkak të situatës së brishtë të sigurisë por, sipas tij, ai do të duhej ta riste edhe angazhimin diplomatik me Bashkimin Evropian. "Do të doja ta shihja Rutten duke punuar më afër me presidenten e Komisionit Evropian - që prapë pritet të jetë Ursula von der Leyen - në atë mënyrë si ka punuar ish-sekretari i përgjithshëm i NATO-s, George Robertson, me ish-përfaqësuesin e lartë të BE-së, Javier Solana, për ta shmangur luftën në Maqedoni [në fillim të viteve 2000]. Me misionin të përbashkët që përçojnë të njëjtin mesazh, unë mendoj se mund të shohim përparim më të shpejtë", thotë Shea. Një tjetër gjë që, sipas tij, është koha të ndodhë, është forcimi i partneritetit mes NATO-s dhe Kosovës. Pas shpërthimit të luftës në Ukrainë, autoritetet në Kosovë kanë kërkuar anëtarësim të përshpejtuar në NATO por, marrë parasysh se në radhët e saj janë katër shtete që nuk e njohin Kosovën - Greqia, Spanja, Rumania dhe Sllovakia - dhe vendimi për zgjerimin duhet të merret në mënyrë unanime, ajo kërkesë nuk ka shkuar përpara.

34 vjet nga Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut, deputetët tregojnë se për dy muaj ishte punuar vetëm natën dhe në mënyrë ilegale

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 KORRIK - Para 34 vitesh është miratuar Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut e vitit 1990, e cila u shpall nga delegatët e Kuvendit të Kosovës. Ky është akti që shënoi hapin historik institucional të pavarësisë të Kosovës.

Miratimi i Deklaratës Kushtetuese u zhvillua në kushte të jashtëzakonshme, të rrethuara nga forca policore serbe.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë kanë mbajtur të martën konferencën shkencore "Zhvillimi i konstitucionalizmit shqiptar 1912-2024".

Në 34-vjetorin e miratimit të Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut, deputetët të atëhershëm të Kuvendit të Kosovës kanë treguar për kushtet në të cilat ishin mbledhur dhe se ishin të rrethuar nga forcat policore e shërbimi sekret serb.

Nënkryetari i Kuvendit të atëhershëm të Kosovës, Iljaz Ramajli, ka theksuar se Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut i ka paraprirë unifikimi i plotë shqiptar. "Deklaratën Kushtetuese të 2 korrikut e shkroi akademik Gazmend Zajmi, Kushtetutën e Kosovës - 7 shtatorit 1990 e shkruan anëtarët e Komisionit Kushtetues të Kuvendit të Kosovës nga radhët e punëtorëve shkencorë, profesor doktor Ejup Statovci, profesor doktor Ismet Salihu, profesor doktor Kurtsh Salihu, profesor doktor Fatmir

Fehmiu si dhe doktor Riza Smaka. Tekstin e pyetjes së referendumit gjithëpopullor, i mbajtur më 26-30 shtator 1991 për Kosovën shtet sovran dhe të pavarur, e kishte përgatitur akademik Gazmend Zajmi me ekipin e tij dhe amendamentet në Kushtetutën e Kosovës nga numri dy deri në atë të shtatën i kishte përgatitur profesor doktor Arsim Bajrami dhe juristi i mirënjohur Lazim Salihu. Shpalljes së deklaratës kushtetuese të 2 korrikut i kishin paraprirë unifikimi i plotë i faktorit shqiptar të Kosovës, kërkesat gjithëpopullore për mëvetësi, liri e barazi", ka thënë Ramajli.

Muharrem Shabani, i cili e kishte lexuar Deklaratën Kushtetuese të 2 korrikut, ka theksuar se kuvendi i atëhershëm u mbajt në kushte të jashtëzakonshme e nën rrethimin e shërbimeve sekrete serbe. "Gjendja në Kosovë në ato vite ishte tepër e rëndë, edhe e sigurisë edhe e politikës. Më 23 mars 1989 në mënyrë të dhunshme ishte suprimuar ajo autonomi sipas Kushtetutës të vitit 1974. Prandaj edhe ky kuvend që u mbajt më vonë u mbajt në kushte të jashtëzakonshme, nën rrethimin policor, të shërbimeve sekrete serbe. Jo për të shprehur guxim e trimëri, por aty ishte treguar guximi i këtyre delegatëve dhe delegateve që me çdo sakrificë të realizojnë këtë akt. U paraprin shumë ngjarje të rënda, burgosje, izolim të intelektualëve, vrasje, kthimin e shumë ushtarëve në arkivole të vrarë, bile-bile thuhej se kanë bërë vetëvrasje, pastaj helmime masive të nxënësve në

shkolla të mesme. Këto edhe neve na bën edhe më të qëndrueshëm që kërkesa gjithëpopullore që u fol këtu që Kosova të shpallet si njësi e barabartë", ka treguar Shabani.

Në këtë konferencë shkencore ai shtoi se Deklarata Kushtetuese ishte pikënisje për Kushtetutën dhe referendumin.

Për hartimin dhe miratimin e Kushtetutës së Kosovës më 7 shtator 1990 foli Ismet Salihu, i cili tha se gjatë dy muajve është punuar vetëm natën dhe në mënyrë ilegale. "Gjatë muajit korrik dhe gusht në mënyrë sistematike grupi punues nga pala shqiptare vazhdoi punën në hartimin e tekstit të Kushtetutës së Kosovës. Gjatë këtyre dy muajve anëtarët e komisionit punuan vetëm gjatë natës dhe në mënyrë ilegale, në konspiracion të plotë. Punët teknike i kryente sekretari i komisionit kushtetues. Dhe kështu gjatë dy muajve është punuar në ilegalitet për përgatitjen e tekstit të Kushtetutës", ka thënë ai.

Me rastin e 34-vjetorit të Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut të vitit 1990, presidentja Vjosa Osmani ka takuar një pjesë të delegatëve të asaj kohe. Osmani ka thënë se Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut ishte pikënisje drejt realizimit të idesë së kamotshme për Kosovën shtet të pavarur. "Sot, në këtë përvjetor, pata nderin t'i takoj një pjesë të delegatëve të asaj kohe, guximi dhe vendosmëria e të cilëve shënuan një akt historik, me të cilin u vendosën themelet për realitetin e sotëm - Republikën e pavarur dhe sovranë të Kosovës", ka shkruar Osmani në

"Facebook".

Kandidati për kryeministër i PDK-së, Bedri Hamza, duke kujtuar këtë datë, ka thënë se veprimtarë të shumtë, brez pas brezi, bënë përpjekje që t'i realizojnë aspiratat e popullit për liri, pavarësi e demokraci.

"Aty ku e linte një brez, menjëherë e vazhdonte tjetri, deri në jetësimin e plotë të ëndrrës shekullore për shtetësinë tonë. Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut 1990 ishte një moment tejet i rëndësishëm politik dhe historik që i bashkoi shqiptarët. Ishte një akt i lartë kur edhe institucionalisht u shpreh vullneti i delegatëve shqiptarë për Kosovën, si njësi të pavarur dhe të barabartë me republikat e atëhershme. Me peshën historike që bartën mbi supet e tyre, sot, 34 vjet pas, vazhdojmë të ndjejmë krenari për vendimin e guximshëm të delegatëve shqiptarë të asaj kohe. Ne kemi pasur gjithnjë burra e gra, djem e vajza, dalëzotës të Kosovës!", ka thënë Hamza.

Ndërkaq Lidhja Demokratike e Kosovës ka theksuar se data 2 korrik e vitit 1990 shënon gurthemelin e shtetësisë së Kosovës, ngjarjen e veçantë të vendit në rrugëtimin historik e politik drejt lirisë e pavarësisë së Kosovës. "Nën rrethimin policor e ushtarak serb 114 delegatë, morën guximin ta shpallin Kosovën si njësi të pavarur dhe me të drejta të barabarta brenda federatës së asaj kohe. Si dhe rikonfirmuan vendosmërinë e paepur të popullit të Kosovës, për të qenë e pavarur dhe demokratike", është

thënë në deklaratën e LDK-së, duke shtuar se Lëvizja gjithëpopullore e Kosovës, e prirë nga ish-presidenti Ibrahim Rugova, unifikoi popullin rreth kësaj kauze, vuri bazat juridike e institucionale të shtetësisë si dhe fitoi përkrahjen e botës demokratike. "Këto përpjekje epike u pasuan nga lufta e çlirimtare e popullit të Kosovës dhe ndërhyrja e NATO-s, të cilat sollën përfundimisht lirinë në Kosovë. Në këtë datë të rëndësishme, shprehim mirënjohjen tonë delegatëve të Kuvendit të 2 Korrikut, për guximin në atë kohë me kushte shumë të rënda, në artikullimin e vullnetit të popullit për liri dhe pavarësi. Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut, kujtohet si moment kthesë i rrugëtimin të Kosovës për Kosovën shtet të pavarur e sovran, i integruar në NATO e BE, dhe në miqësi të përhershme me ShBA-të", thuhet në deklaratën e LDK-së. Lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut e vitit 1990 i dërgoi botës mesazhin e përcaktimit të shqiptarëve të Kosovës për liri dhe pavarësi. "Në kohën e pushtimit të egër, ishin 'Delegatët e Pavarësisë' që legjitimuan vullnetin e popullit të Kosovës për pavarësi. Deklarata e 2 korrikut 1990 ishte një gur themelet e lirisë, e cila u jetësua disa vjet më pas nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe aleatët perëndimorë të prirë nga Amerika. Mirënjohës e falënderues për kontributin atdhetar në të gjitha periudhat historike", ka thënë Haradinaj.

Konjufca priti në takim ambasadorin bullgar, diskutuan për thellimin e bashkëpunimit

PRISHTINË, 2 KORRIK - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Bullgarisë në Kosovë, Hristo Gudjev. Duke e falënderuar për mbështetjen e shtetit bullgar ndaj Kosovës, Konjufca shprehu vlerësim për raportet shumë të mira mes dy vendeve, në të njëjtën kohë potencoi nevojën për thellim të bashkëpunimit të ndërsjellë

në fusha të ndryshme të interesit të përbashkët. Ambasadori bullgar Hristo Gudjev e falënderoi Konjufcën për pritjen dhe nënvizoi se Bullgaria do ta vazhdojë mbështetjen për Kosovën edhe në të ardhmen, duke përfshirë këtu synimet e integritit euroatlantik si dhe shprehu gatishmërinë që përmes angazhimit të palëve të fuqizohen edhe më tutje

marrëdhëniet mes vendeve tona. Po ashtu, bashkëbiseduesit folën edhe për aktualitetin politik, sigurinë dhe stabilitetin në rajon, duke u pajtuar për nevojën e bashkërendimit në drejtim të frenimit dhe parandalimit të të gjitha përpjekjeve destabilizuese që rrezikojnë stabilitetin rajonal, që është kusht i përparimit të gjithanshëm.



Kastrati uron bujqit malishevas për fillimin e korrjes së grurit



MALISHEVË, 2 KORRIK - Kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, ka parë nga afër fillimin e fushatës së korrje-shirjeve të grurit dhe, me këtë rast, ka uruar bujqit për një korrje të bereqetshme dhe ka shprehur urimet e tij që ky të jetë një sezon i mbarë.

Gjatë vizitës në terren, kryetari Kastrati ishte i shoqëruar nga drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Blegtori dhe Zhvillim Rural, Sylë Dukolli. Ata kanë premtuar vazhdimin e përkrahjes për

sektorin e bujqësisë, duke theksuar rëndësinë e këtij sektori për ekonominë. "Fillimi i korrjes dhe grumbullimit të grurit është një moment i veçantë për të gjithë ne. Bujqësia është shtylla kurrizore e ekonomisë dhe ne jemi të përkushtuar të mbështesim bujqit tanë në çdo hap të rrugës. Jemi këtu për të festuar përpjekjet dhe arritjet tuaja dhe për të shprehur mbështetjen tonë të vazhdueshme. Urojmë një sezon të mbarë dhe të bereqetshëm", tha

kryetari Kastrati, duke i uruar bujqit.

Vizita e kryetarit dhe drejtorit në arat e grurit u mirëprit nga bujqit, të cilët patën mundësinë të ndajnë me ta sidat dhe përvojat e tyre.

Kastrati dhe Dukolli theksuan se komuna do të vazhdojë të ofrojë mbështetje përmes subvencioneve dhe formave të tjera për t'i përmirësuar kushtet e punës dhe për ta rritur cilësinë dhe sasinë e grurit dhe të prodhimeve të tjera.

Policia dhe Inspektorati Policor përfundojnë trajnimin me DEA

Prishtinë, 2 korrik - Policia dhe Inspektorati Policor kanë përfunduar trajnimin e DEA, Departamenti i Drejtësisë i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës - Programin Ndërkombëtar të Asistencës në Trajnim për Hetimet Kriminale (DOJ-ICITAP), në partneritet me Policinë e Kosovës dhe Administratën për Zbatimin e Drogës (DEA) zhvilluan një kurs

trajnimi njëjavor të suksesshëm për operacione të fshehta. Kursi, i mbajtur në Prishtinë, ka përfshirë 23 pjesëmarrës që përfaqësojnë Policinë e Kosovës dhe Inspektoratin Policor. Programi i hartuar nga DEA u vlerësua për përmbajtjen e tij informative që u dha pjesëmarrësve njohuri të vlefshme për zhvillim profesional. Ceremonia e diplomimit u ndoq

nga zyrtarë të rangut të lartë të agjencive qeveritare të Kosovës si dhe të Shteteve të Bashkuara, duke përfshirë atashun e DOJ/ICITAP Kimberly Riffe, stafin e ICITAP-it, atashun rajonal të DEA-s John Livanis dhe instruktorë të DEA-s. Policia e Kosovës falënderoi ekipet e DD-ICITAP dhe DEA për përkushtimin dhe mbështetjen e palëkundur që kontribuan në avancimin e Policisë së Kosovës.



Pastrimi i lumenjve në Gjilan zvogëloi rrezikun nga vërshimet



GJILAN, 2 KORRIK - Pastrimi i shtretërve të lumenjve, thellimi dhe zgjerimi po vazhdon tani edhe në fshatin Lladovë.

Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, Bejtullah Osmani, ka thënë se gjatë këtij viti është punuar në pastrimin, thellimin dhe zgjerimin e shtretërve të lumenjve Stanishorka në qytet, në Malishevë, Pogragjë, Bresalc, Kmetoc, Kosaqë dhe Përlepnice. "Kjo po bëhet tash dy vjet, me qëllim të zvogëlimin të rrezikut nga vërshimet dhe përmbytjet", ka deklaruar Osmani.

Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim tregoi se gjatë këtij viti është bërë pastrimi i lumit në fshatin Malishevë në tërë gjatësinë e tij rreth 3.5 kilometra. "Kemi pastruar, thelluar dhe zgjeruar lumin në fshatin Përlepnice 1.2 kilometra", ka thënë Osmani. Ai tregoi se kanë pastruar përroskën e fshatit Kosaqë dhe Kmetoc rreth 400 metra. Sipas tij, është intervenuar në pastrimin dhe largimin e mbeturinave nga lumi Moravë në fshatin Pogragjë, te vendi i quajtur "Guveni", afër kalasë, 15

kamionë me mbeturina janë nxjerrë nga lumi.

Osmani ka bërë me dije se është rregulluar edhe shtrati i lumit në fshatin Bresalc, afër shkollës "Ibrahim Uruqi", dhe është zhvendosur në rrjedhën e tij natyrore duke mbrojtur oborrin dhe objektin e shkollës në fjalë. Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim ka theksuar se ky aktivitet do të vazhdojë me intensitet gjatë vitit në pika të tjera të komunës si në Zhegër, Livoç, Cernicë dhe në disa lokacione të tjera.

Hapet shkolla verore "Dielli" në Drenas

Drenas, 2 korrik - Drejtorja Komonale për Arsim e komunës së Drenasit, së bashku me Qendrën për Avancimin e Performancës së Arsimit (QAPA), në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Migjeni" në fshatin Baicë, hapën zyrtarisht shkollën verore "Dielli", një ngjarje e përjetuar me

emocione nga të gjithë nxënësit dhe stafi i shkollës. Në hapjen e kësaj shkolle fjalë rasti mbajtën drejtori i Arsimit në komunën e Drenasit, Muhamet Gjoka, i cili i thirri të gjithë t'i gëzojnë aventurat e reja të verës, të mësojnë dhe të rriten nën diellin e ndritshëm dhe frymën frymëzuese të hapjes

së shkollës së tyre verore. Pas tij, me fjalë përshëndetëse u paraqitën edhe drejtori i QAPA-së, Nehat Mustafa dhe kryetari i Këshillit të Prindërve, Arben Haziri.

Drejtori Gjoka qëndroi me nxënësit pasdite, duke zhvilluar një bashkëbisedë të këndshme me ta.



IKD-ja: Qeveria miratoi ligje në kundërshtim me Kushtetutën dhe realizoi vetëm 15 % të agjendës legislative

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), gjatë monitorimit të zbatimit të programit legjislativ brenda programit “Qeverisja e Mirë”, ka theksuar se qeveria miratoi ligje në kundërshtim me Kushtetutën, shkeli aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese, mori vendime pa konsultime të mjaftueshme publike, dhe realizoi vetëm 15 % të agjendës legislative të planifikuar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 2 KORRIK - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) çdo vit monitoron zbatimin e programit legjislativ brenda programit “Qeverisja e Mirë”.

Vlerësimi bazohet në indikatorë si planifikimi adekuat, kushtetutshmëria, ligjshmëria, transparenca dhe pjesëmarrja e publikut në procesin e vendimmarrjes.

Ky monitorim vlerëson nëse procesi legjislativ është në përputhje me standardet demokratike dhe ka përfshirë të gjithë aktorët relevantë.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024 IKD-ja ka identifikuar mangësi thelbësore në qasjen e Qeverisë së Kosovës ndaj planifikimit legjislativ.

Sipas IKD-së, për të tretin vit radhazi qeveria dështoi ta miratojë programin legjislativ në fillim të janarit, duke e miratuar me një muaj vonë. “Kjo vonëse ka cenuar procesin e planifikimit dhe ka krijuar pasiguri për publikun, organizatat e shoqërisë civile, qytetarët dhe institucionet përkatëse. Pas miratimit të vonuar, programi legjislativ shpesh është ndryshuar, duke treguar mungesën e një strategjie të qartë dhe të qëndrueshme. Programi për këtë vit iu nënshtrua ndryshimeve në shkurt”, thuhet në komunikatën e IKD-së.


Një tjetër çështje shqetësuese është mospërfshirja në programin legjislativ të projektligjeve që rrjedhin nga aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese, Planit Kombëtar për Zhvillim dhe Programit Qeverisës 2021-2025. Këto projektligje janë thelbësore për përmbushjen e detyrimeve kushtetuese dhe për zhvillim të qëndrueshëm. “Mospërfshirja e tyre reflekton mungesë përkushtimi ndaj reformave strukturore dhe prioritetëve të qeverisë. Kjo mangësi e përsëritur tregon paaftësi në zbatimin e politikave publike, duke vënë në pikëpyetje efektivitetin e qeverisjes dhe aftësinë për të adresuar nevojat e qytetarëve. Për më tepër, kjo neglizhencë mund të shkelë standardet demokratike dhe të zbehë besimin e qytetarëve në institucionet shtetërore”, ka vlerësuar IKD.

Sipas programit legjislativ, qeveria planifikoi miratimin e 52 projektligjeve deri në qershor, por nga 52, ajo miratoi vetëm 8, ose 15 % të projektligjeve të planifikuara. “Gjatë kësaj periudhe, Qeveria miratoi edhe 10 marrëveshje ndërkombëtare që nuk ishin planifikuar për miratim në programin legjislativ. Nga ana tjetër, Qeveria tregoi shpejtësi në miratimin e dy projektligjeve: njëri i planifikuar për shtator dhe miratuar në qershor (Projektligji për Financimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore) dhe tjetri planifikuar për dhjetor dhe miratuar në prill 2024 (Projektligji për Provimin e Maturës Shtetërore). Në bazë të rezultateve të lartcekura, efikasiteti i Qeverisë në realizim të agjendës legislative për gjashtëmujorin e parë do të arrihte vetëm 32%”, ka theksuar IKD.

IKD-ja gjen se disa ministri, edhe pse kishin planifikuar miratimin e projektligjeve, ato nuk i miratuan sipas afateve të planifikuara në programin legjislativ. Këto ministri janë: Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Sa iu përket ministrive që kanë miratuar projektligje sipas planifikimeve, në këtë çështje prin Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me tre projektligje, Ministria e Drejtësisë me dy projektligje, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike me dy projektligje, dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me një projektligj.

Në raport me premtimet elektorale, zotimet me Programin Qeverisës 2021-2025 dhe me planifikimet në Planin Kombëtar për Zhvillim dhe dokumente të tjera strategjike të miratuara nga Qeveria e Kosovës, IKD-ja gjen se në premtimet kyçe qeveria Kurti ka dështuar t'i përcjellë fillimisht për miratimin e projektligjeve e atëherë kur i ka miratuar, ato kanë qenë në kundërshtim me Kushtetutën, po ashtu disa ligje i ka proceduar vetëm pas detyrimit nga Gjykata Kushtetuese.



Në fushën e drejtësisë, respektivisht në reformën e drejtësisë, është rrëzuar Ligji për Këshillin Prokurorial dhe Ligji për Byronë, në anën tjetër amendamentet kushtetuese për vettingun janë konfirmuar pjesërisht nga Gjykata Kushtetuese e për më tepër ato kanë mbetur peng në procedurën parlamentare për shkak të bojkotit të punës së Kuvendit nga ana e Listës Serbe.

Në anën tjetër, siç do të përmendim më tutje, qeveria dështoi që të r-procedojë për miratim Projekt Kodin Civil të Republikës së Kosovës. Për më tepër, Ministria e Drejtësisë, edhe pse planifikoi që gjashtë projektligjet të dala nga Deklarata e Zotimeve të miratohen më 28 qershor 2024, ajo këto projektligje i vendosi në Platformën Online të Konsultimeve Publike për të marrë komente deri më 2 korrik 2024.

Në fushën sociale, qeveria Kurti 2 ka dështuar deri më tani që ta miratojë pjesën më të madhe të projektligjeve të planifikuara që nga viti 2021.

Në fushën e ekonomisë, mungesa e efikasitetit në miratimin e projektligjeve vërehet qartë. Qeveria, siç shihet nga monitorimi, rezulton se ende nuk ka miratuar Projektligjin për Zonat Ekonomike, Projektligjin për Nxitjen dhe Mbrojtjen e Investimeve, Projektligjin për

Inovacion dhe Ndërmarrësi, Projektligjin për Prokurim Publik, Projektligjin për Partneritetin Publiko-Privat, Projektligjin për Menaxhimin e Financave Publike, Projektligjin për Auditorin e Përgjithshëm të Republikës së Kosovës dhe për më tepër, qeveria nuk ka proceduar këtë vit rishikimin e buxhetit vjetor ashtu siç ka qenë praktikë e mëhershme.

Në fushën e sigurisë dhe mirëqenies së policisë, qeveria ende nuk ka miratuar ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për Policinë dhe Ligjin për Pensionimin e Parakohshëm të Policisë së Kosovës.

IKD-ja, po ashtu, vëren se ftesa e kryeministrit të Kosovës drejtuar partive politike parlamentare në lidhje me zbatimin e programit legjislativ ka qenë e pasinqertë pasi që kryeministri Kurti për tri vitet e kaluara ka pasur qasje përjashtuese e shpeshherë ofenduese ndaj opozitës. Duke shtuar faktin këtu se një ftesë e tillë erdhi gati se krejt në fund të legjislaturës së tetë. “Në anën tjetër, vetë kryeministri, gjatë gjithë vitit 2023 e po ashtu edhe gjatë vitit 2024 nuk i është përgjigjur deputetëve në pyetjet parlamentare dhe çështjet që kanë ngritur ata. Për herë të parë në historinë e parlamentarizmit në Kosovë, ai ka ndërtuar praktikën e dëmshme të përjashtimit dhe shmangies nga

kontrolli parlamentar duke mos iu përgjigjur pyetjeve të përfaqësuesve të qytetarëve”, thuhet në komunikatën e IKD-së. Sa iu përket konsultimeve publike, IKD gjen se në shtatë ligjet e miratuara, të cilat i nënshtrohen procesit të konsultimeve publike, vetëm në një rast ajo nuk respektoi këtë obligim dhe standard të transparencës dhe qeverisjes së mirë.

Në një rast, IKD-ja gjen se qeveria në kundërshtim me standardet e qeverisjes së mirë dhe në kundërshtim edhe me standardet e parlamenteve demokratike, riprocedoi Projektligjin për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e Institucionit Korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve daneze, katër ditë pas dështimit për votim në Kuvendin e Kosovës.

Sa i përket kushtetutshmërisë, Gjykata Kushtetuese (GJK) rrëzoi tërësisht Ligjin nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme dhe pjesërisht Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Nenet e rrëzuara ishin themelore për synimin dhe qëllimin e qeverisë.

AIP kërkon nga ndërmarrjet publike dhe private mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve

PRISHTINË, 2 KORRIK - Bazuar në mandatit e saj ligjor, për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve, përkatësisht dispozitat e Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) u ka bërë thirrje ndërmarrjeve publike dhe private mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve gjatë ofrimit të shërbimeve, përkatësisht gjatë shpërndarjes së faturave të konsumatorët (qytetarët).

Në zbatim të përgjegjësisë të saj ligjore, Agjencia për Informim dhe Privatësi në fund të muajit shkurt 2024 ka kërkuar nga të gjitha ndërmarrjet publike dhe private ndërmarrjen e masave të sigurisë gjatë shpërndarjes së faturave të konsumatorët (qytetarët). "Afati për ndërmarrjet publike dhe private që shpërndajnë fatura tek qytetarët për të vendosur faturat në zarfe për shkak të mbrojtjes së të dhënave personale ka qenë 30 qershori 2024. Kërkesa është



adresuar për të siguruar mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve, duke parandaluar ekspozimin e paautorizuar të tyre", është thënë në njoftimin e AIP-së.

Më tutje theksohet se në kuadër të sigurimit të mbrojtjes së të dhënave personale të qytetarëve të Republikës së Kosovës, Agjencia për Informim dhe Privatësi kërkon nga ndërmarrjet

publike dhe private që ofrimin e shërbimeve për qytetarët (shpërndarjen e faturave) ta realizojnë në formatin që garanton mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve nga

ekspozimi dhe qasja e paautorizuar. "Rrjedhimisht, Ndërmarrjet Publike dhe Private janë të obliguara të ndërmarrin masat e duhura të sigurisë me rastin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët (shpërndarjes së faturave) dhe të vendosin masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rreziqeve të mundshme të keqpërdorimit të të dhënave personale të qytetarëve", thuhet në njoftimin për medie.

Në këtë kontekst, AIP kërkon nga këta kontrollues zbatimin e rregullave dhe standardeve për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve të Republikës së Kosovës siç përcaktohet me Ligjin nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. "Qëllimi i Agjencisë për Informim dhe Privatësi është përbushja e mandatit të saj ligjor në mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve për të parandaluar ekspozimin e paautorizuar të tyre", thuhet në njoftimin e AIP.

Oda Ekonomike Amerikane ndau Çmimet e Partneritetit ShBA - Kosovë

PRISHTINË, 2 KORRIK - Në prag të Ditës së Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Oda Ekonomike Amerikane ndau Çmimet e Partneritetit ShBA - Kosovë për kompanitë që kanë kontribuar në marrëdhëniet e fuqishme të biznesit ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara.

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier, iu drejtua anëtarëve, partnerëve dhe pranuesve të mirënjohjeve, duke theksuar rëndësinë e partneritetit ShBA - Kosovë.

Ambasadori Hovenier vuri në dukje se kompanitë të cilat pranuan mirënjohjet jo vetëm që ndihmojnë bizneset amerikane të zgjerohen globalisht, por sjellin produkte dhe shërbime të cilësisë së lartë nga Kosova në Shtetet e Bashkuara. Ai shtoi se këto kompani luajnë rol vendimtar për t'i bërë Shtetet e Bashkuara një nga partnerët më të rëndësishëm tregtarë të Kosovës. Ai theksoi rritjen e jashtëzakonshme të eksporteve të Kosovës në ShBA, nga 2.7 milionë euro në 2019 në mbi 100 milionë euro në vitin 2023.



Gjithashtu, ambasadori Hovenier tha se përkushtimi i Shteteve të Bashkuara ndaj Kosovës mbetet i fortë si kurrë më parë, me kompani si ato që nderohen sot që sigurojnë lidhje të forta mes njerëzve dhe bizneseve. Blin Zeqiri, kryetar i Bordit të Guvernatorëve të Odës

Amerikane, shprehu mirënjohjen e tij për partnerët dhe miqtë amerikanë për hapjen e rrugëve të rritjes dhe zhvillimit për Kosovën, duke sjellë burime financiare, ekspertizë të çmueshme, inovacion dhe, më e rëndësishmja, frymën e ndërmarrësisë amerikane, duke shtuar se Oda Amerikane ka

qenë thelbësore në fuqizimin e kësaj marrëdhënieje, duke ofruar një platformë për dialog, bashkëpunim dhe rritje reciproke.

Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, tha se kompanitë të cilat nderohen me çmime kanë prirë në importimin e mallrave dhe shërbimeve

amerikane, eksportimin e produkteve të Kosovës në ShBA dhe investimin në ekonominë e njëra-tjetrës, duke shtuar se ato jo vetëm që nxisin rritjen ekonomike, por shërbejnë edhe si ambasadorë të marrëdhënie të forta dhe të qëndrueshme mes dy kombeve tona.

Kompanitë e shpërblyera me Çmimet e Partneritetit ShBA - Kosovë janë: LAB-OIL, Poligoni i Shenjtarisë Katana, Delfin, Meditech, Auto Kaçandolli, Ventius International, Limak Kosovo International Airport, Minna, Walone Fashion Group, Artmotion, Nettzio, Radix Software Inc., RIT Kosova, Sutherland Global Services Kosovo, BP - Home Invest, Stonecastle Vineyards & Winery, Coca-Cola HBC, Birra Peja, Royal Beverage, AGNA Kosova, ELKOS Group, Meridian Corporation, Yesspharma, dhe Kostrade.

Ky aktivitet shënoi edhe inaugurimin zyrtar të hapësirës ekspozuese "AmCham Expo Space" në "Prishtina Mall", dedikuar promovimit të kompanive anëtare të Odës Amerikane dhe ekspozimit të mallrave dhe shërbimeve të tyre.

Alarm i rrejshëm për bombë në Aeroportin e Prishtinës

PRISHTINË, 2 KORRIK - Dyshimet për alarm për bombë janë raportuar të martën në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari". Mirëpo sipas zyrtarit për marrëdhënie me publikun nga ANP "Adem Jashari", Bujar Gashit, alarmi për bombë ka

rezultuar të jetë i rrejshëm. Sipas tij, Aeroporti Ndërkombëtar 'Adem Jashari' është i hapur për fluturime dhe të gjitha fluturimet do të realizohen si zakonisht. "Ju njoftojmë se pas kërcënimit për bombë janë ndërmarrë të gjitha veprimet operative dhe

hetimore nga organet kompetente të Republikës së Kosovës. Kjo ka rezultuar se kërcënimi për bombë ka qenë alarm i rrejshëm. ANP 'Adem Jashari' LKIA është i hapur për fluturime dhe të gjitha fluturimet do të procesohen si zakonisht", ka thënë Gashi.



Budallai inteligjent

Eshtë e rëndësishme të kuptojmë se sjellja prej budallenjsh nuk është e kufizuar vetëm tek njerëzit me të ashtuquajturin “nivel të ulët inteligjence”. Atë e gjen shpesh edhe tek njerëz që kanë pozicione të larta në politikë, arte dhe shkencë. Ata që mendojnë se të qëniet të zgjuar në një fushë, i bën ekspertë në të gjitha fushat e tjera

Kur Sokrati kërkonte nëpër Athinë për njeri inteligjent – veçanërisht një person që ishte më i mençur se ai – ai hasi në diçka të papritur. “Ata me reputacion më të madh më dukeshin,” deklaroi ai, “praktikisht më të mangët. Nga ana tjetër, ata që ishin “gjoja inferiorë” iu dukën filozofit grek si “më të kompletuar”.

Në kërkimin e tij për të gjetur njeriun më të mençur në Athinë, Sokrati iu afrua politikanëve, poetëve dhe zejtarëve. Ai u takua me ekspertë politikë që kishin, në të vërtetë, njohuri të jashtëzakonshme mbi çështjet politike, por që nuk ishin domosdoshmërisht të mençur dhe as që e ushtronin arsyen e

shëndoshë në çështjet e jetës së përditshme.

E njëjta gjë mund të thuhet për poetët. Sokrati zbuloi se talenti i një poeti me fjalën, nuk shfaqej edhe në aftësitë e tjera të tij. Shpesh herë, ata i thonë gjërat me shumë finesë, deklaroi ai, “pa patur dijeni për atë që po thoshin”. Dhe më tej, vazhdoi: “Vura re gjithashtu se fakti që bënë poezi, i bënte të mendonin se ishin ndër më të mençurit mes njerëzve, edhe në gjërat e tjera, por që në të vërtetë nuk ishin”.

Edhe zejtarët ishin shumë të zotë për të realizuar skulptura, piktura, poçe dhe për shkak të kësaj “secili prej tyre pretendonte se ishte më i mençuri edhe në të tjera fusha”. Ky gabim në të menduar – pra që për shkak se je i aftë në diçka, je domosdoshmërisht i aftë edhe në fusha të tjera – dukej se ua errësonte atë mençuri që vërtet e zotëronin, përfundoi filozofi.

Psikologu klinik gjerman Andreas Maercker e përcakton budallallëkun si të menduarit e ngurtë, dogmatik dhe joelastik, që sipas tij, shpie në ndjesinë e



hidhësisë dhe mërzi.

Të tillë njerëz i ndeshim në përditshmërinë tonë, ndeshim atë personazhin që jep mendje për këtë njeri apo atë ngjarje, por që i mungojnë aftësitë e nevojshme, për të qenë ekspert në temën për

të cilën flet.

Sipas përcaktimit të Maeckerit, këta njerëz veprojnë si budallenj, që është e kundërta e mençurisë. Eshtë e rëndësishme të kuptojmë se sjellja prej budallenjsh nuk është e kufizuar vetëm tek njerëzit

me të ashtuquajturin “nivel të ulët inteligjence”. Atë e gjen shpesh edhe tek njerëz që kanë pozicione të larta në politikë, arte dhe shkencë. Ata që mendojnë se të qëniet të zgjuar në një fushë, i bën ekspertë në të gjitha fushat e tjera.

Preja e përsosur e propagandës



Njerëzit dikur besonin se të mësuarit e leximit ishte provë e progresit të njerëzimit. Ata vazhdojnë ta lëvdojnë zvogëlimin e analfabetizmit si një fitore të madhe. Ata dënojnë dhe qortojnë ata vende që kanë një përqindje të lartë të analfabetëve. Besojnë se leximi është një rrugë drejt lirisë.

E gjithë kjo është e debatueshme, sepse gjëja më e rëndësishme nuk është që të jesh i aftë të lexosh, por të kuptosh atë që lexon, të reflektosh dhe të gjykos mbi atë që lexon.

Përtej kësaj, leximi nuk ka kuptim (dhe madje ai shkatërron disa cilësi automatike të kujtesës dhe vëzhgimit).

Por të flasësh për aftësitë kritike dhe mprehtësinë, duhet të përqëndrohesh shumë më lart se sa arsimit fillor dhe të marrësh në konsideratë një pakicë shumë të vogël.


Shumica dërmuese e njerëzve, ndoshta 90 përqind e tyre, dinë se si të lexojnë por nuk e ushtrjnë inteligjencën e tyre përtej kësaj.

Ata ia atribuojnë autoritetin dhe vlerën fjalës së shkruar, ose e anasjellta, e hedhin poshtë tërësisht atë. Duke qenë se këta njerëz nuk zotërojnë njohuritë e mjaftueshme për të reflektuar dhe gjykuar, ata besojnë – ose nuk besojnë – në mënyrë totale atë që besojnë.

Dhe duke qenë se këta njerëz

zakonisht zgjedhin çështjet më të kollajta dhe jo ato më të vështira, ata janë ekzaktesisht në atë nivel, që i mundëson fjalës së shkruar që t'i bindë, pa ndeshur në asnjë kundërshti. Janë preja e përsosur e propagandës.

Jacques Ellul, “Propaganda: Formimi i qëndrimeve të njeriut”, 1965



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Khaka: Italinë e mposhtëm ende pa zbritur në fushë

BERLIN, 2 KORRIK - Zvicra arriti fitore të madhe në 1/8 e finales në "Euro 2024", duke mposhtur Italinë me rezultat 2-0. Padyshim që Granit Xhaka ka qenë një nga më të mirët në fushë, derisa ka folur për fitoren që arritën ndaj Italisë. Mesfushori nga Kosova ka thënë se ai dhe disa nga futbollistët e Zvicrës kanë shkuar në "Euro 2024" pas një sezoni të madh dhe se janë të uritur për sukses. "Unë urrej të humbas. As në stërvitje nuk e pranoj humbjen. Unë dhe Akanji zhvilluam një sezon të madh, ashtu si edhe tre lojtarët që vijnë nga Bologna. Në përgjithësi të

gjithë lojtarët kanë bërë mirë këtë sezon dhe ne jemi të 'urit' për më shumë. Italinë nuk e kisha parë kurrë në këtë gjendje. Ishte shumë në vështirësi. Mendoj se ne e fituam ndeshjen ende pa zbritur në fushë, kështu bënë edhe ata me ne para tre vitesh", ka thënë Xhaka. "Jam shumë krenar për atë që kemi treguar. Jam krenar për çdo pjesëtar të skuadrës dhe stafit, sepse kjo që kemi arritur është shumë speciale. Jo vetëm për rezultatin, por edhe për performancën dhe lojën e shprehur. Kemi luajtur në nivel të shkëlqyeshëm dhe kemi qenë

mentalisht shumë mirë, edhe pse përballë kishim një kundërshtar prestigjioz", ka shtuar Xhaka. Mesfushori i Bayer Leverkusnit ka shtuar se kjo ishte një hakmarrje ndaj Italisë, e cila tri vjet më parë e kishte eliminuar me lehtësi. "E kishim në mendje atë disfatë 3-0 ndaj Italisë para tre vitesh, por këtë herë treguam shumë shpirt skuadre dhe arritëm një objektv që ishte më se i merituar. Çdo fitore na shton më shumë besimin. Ishim të disiplinuar taktikisht edhe me topin në zotërim, por edhe kur kundërshtari e kishte topin në kontroll", u shpreh Xhaka.



KF Dukagjini kompletion stafin e trajnerëve

Skuadra e Dukagjinit nga Klina ka bërë ndryshime në shtabin teknik. Në vend të Armend Dallkut në pozitën e shefit të shtabit teknik është angazhuar Ismet Munishi, derisa të martën kjo skuadër ka bërë me dije se stadin teknik e

plotësojnë edhe dy emrat e njohur, Ardian Basha dhe Ndue Pergjokaj. "Stafi i trajnerëve është kompletuar me dy ndihmesë-trajnerët Ardian Basha dhe Ndue Pergjokaj. Shtabi teknik që udhëhiqet nga kryetrajneri Ismet Munishi tani

kompletohet me ardhjen e dyshes Basha dhe Pergjokaj. Ata me përvojën e tyre do ta ndihmojnë klubin për arritjen e synimeve për sezonin e ri. Ne ju urojmë mirëseardhje dhe suksese", thuhet në njoftimin e Dukagjinit.

Kuç: Nuk më ka mbetur asgjë peng nga futbollit i Kosovës

PRISHTINË, 2 KORRIK - Edvin Kuç u largua nga Ballkani pas pesë viteve e gjysmë të kaluara te skuadra kampione e Kosovës. Mesfushori shqiptar me pasaportë malazeze karrierën do ta vazhdojë me skuadrën nga Azerbajxhani, Neftçi Baku. Ai tanimë ka nisur përgatitjet për

sezonin e ri me Neftçin. Në një lidhje të drejtpërdrejtë me Radio Dukagjinin ka folur për aventurën në Azerbajxhan. Kuç deklaroi se u largua nga Ballkani për të marrë një kontratë më të mirë pasi tanimë është në pjesën e fundit të karrierës së tij si futbollist. "Me të thënë të

drejtën, 30-vjeçar dhe me Ballkanin kam fituar të gjitha. Erdhi koha të mendoj për ekzistencë dhe për familje. Kur vjen në përfundim të karrierës duhet menduar më shumë për familjen dhe për të gjitha. Falë Zotit me Ballkanin ka shkuar gjithçka super duke fituar

trofetë dhe jam larguar si kampion", ka thënë Kuç. "Nuk më ka mbetur asgjë peng nga futbollit kosovar, pasi me Ballkanin kam kaluar super. Më kanë ndihmuar njerëzit në klub në qytet dhe kam bërë shumë miq dhe ky është fitimi më i madh për mua", ka shtuar Kuç.



SHKURT

Kodra nga Zvicra vjen te Ballkani

Futbollisti i talentuar Merlind Kodra është përforcimi më i ri i skuadrës së Ballkanit në këtë afat kalimtar. 19-vjeçari në skuadrën kampione të Kosovës vjen nga Zvicra, konkretisht nga Grasshopper Zurich. "Me kënaqësi bëjmë me dije se skuadra është përforcuar me mbrojtësin e djathtë Merlind Kodra, i cili vjen nga Zvicra për t'iu bashkuar klubit tonë. Futbollisti 19-vjeçar që karrierën e ka kultivuar në të gjitha gjeneratat e klubit të njohur zviceran, Grasshopper Zurich, do të jetë pjesë e FC Ballkanit për pesë vitet e ardhshme. Klubi i dëshiron Merlindit suksese në arritjen e të gjitha objektivave tona të përbashkëta", thuhet në njoftimin e Ballkanit.

Evertoni interesohet për Brojën, Chelsea kërkon 25 milionë paunda

Sulmuesi kuqezi Armando Broja me gjasë do të largohet nga Chelsea në këtë afat kalimtar. "Blutë" e Londrës e kanë futbollistin në listën e lojtarëve që do të largohen nga skuadra gjatë këtij seksioni merkatoje. Sipas një raporti të fundit nga "The Guardian", Chelsea shpreson të arkëtojë 25 milionë paund nga shitja e sulmuesit shqiptar. Në fakt, interesim serioz ka nga skuadra e Evertonit, klub i cili është gati ta paguajë shifrën e përmendur. Për yllin kuqezi kalimi te Evertoni do të ishte një mundësi për ta treguar veten, duke marrë parasysh faktin se ai do të kishte në dispozicion minutazhin e duhur. Broja, pas "shtegtimit" të fundit te Fullhemi që nuk rezultoi e suksesshme, kërkon të nisë edhe një herë nga e para, me shpresën se gjithçka do të shkojë mirë. 22-vjeçari u aktivizua me Shqipërinë në Evropian. Ai luajti 77 minuta me Italinë dhe 33 minuta me Spanjën, ndërsa ndaj Kroacisë qëndroi në bankinë.

Brentfordi kërkon 4 milionë euro për Strakoshën

Katër milionë euro është çmimi për të cilin portieri i kombëtares shqiptare, Thomas Strakosha, mund të shitet në merkaton e kësaj vere. Anglezët e Brentfordit kanë fiksuar çmimin për gardianin e portës, teksa ofertat nuk mungojnë. Strakosha siç përfillet prej disa ditësh është në radarët e klubeve të Serisë A, me Fiorentinën që ka bërë hapa konkretë për 29-vjeçarin. "Corriere dello Sport" konfirmon interesimin e skuadrës italiane dhe në të njëjtën kohë zbulon se Brentfordi kërkon 4 milionë euro për ta lënë Strakoshën të largohet nga Londra. Sakaq, gardiani kuqezi është edhe në listën e dëshirave të AEK-ut. Verdhezinjtë pas largimit të Stankoviçit dhe Athanasiadis synonin Alberto Brignoli, por 32-vjeçari pritet të përfundojë kalimin te gjermanët e Union Berlinit. Pas paraqitjeve të shkëlqyera në Evropian, AEK është bindur se duhet ta transferojë Strakoshën, por ai nuk është i vetmi që po konsiderohet nga "verdhezinjtë".

Ademi transferohet në Kroaci te NK Osijek

OSIJEK, 2 KORRIK - Kemal Ademi është larguar nga futboli zviceran dhe karrierën do ta vazhdojë në Kroaci. Sulmuesi nga Kosova së fundmi ishte pjesë e Luzernit në Superligën e Zvicrës, derisa është paraqitur si lojtari më i ri i skuadrës kroate Osijek. "Po, jam 28-vjeçar dhe tashmë kam

qenë në shumë klube dhe vende, duke filluar nga Zvicra, përmes Turqisë, Rusisë dhe Gjermanisë dhe Zvicrës përsëri. Fjala vjen, unë kam lindur në Gjermani, por familja ime shkoi shpejt në Zvicër dhe fillova të luaj futboll atje. Kam ndryshuar sisteme dhe formacione të shumta.

Kudo jam përpjekur të përshtatem sa më mirë. Kam pasur shumë bashkëlojtarë të famshëm dhe shumë cilësorë si Mesut Ozil, Luiz Gustavo, Diego Perotti e të tjerë. Kam luajtur kundër Shakhtarit kur Jose Boto ishte drejtor sportiv atje dhe tani më thirrri të vij në Osijek", ka thënë Ademi. "Kam

përvojë edhe nga Liga e Kampionëve dhe kualifikueset e Konferencave, e cila më pret edhe këtu. Meqë ra fjala, jam mirë në atë kompeticion. Kam shënuar dy gola teksa luaja për Luzernin. Shpresoj të jem i suksesshëm dhe efektiv edhe për Osijekun", ka deklaruar Ademi.



Ronaldo: Ky është Evropiani im i fundit

FRANKFURT, 2 KORRIK - Cristiano Ronaldo festoi fitoren ndaj Sllovenisë, por e gjithë ndeshja ishte një makth i vërtetë për të, pasi portieri kundërshtar Jan Oblak e përloti atë. Ronaldo u përpoq të shënonte gjatë gjithë ndeshjes, por nuk shkoi siç ishte planifikuar. Katër herë ka goditur nga gjuajtja e lirë, ka dalë i vetëm ndaj portierit sloven, por Oblak ka qenë më i suksesshëm në çdo rast. Goditja e fundit erdhi në pjesën e parë të vazhdimeve, kur gjyqtari Daniele Orsato i dha Portugalisë një penallti. Ronaldo mori përgjegjësinë, por Oblak edhe një herë bëri një pritje fantastike. Pas penalltisë së humbur, portugezi i famshëm u pushtua nga emocionet dhe nuk i fshehu dot lotët në mes të fushës në Frankfurt. Megjithatë, gjatë gjuajtjes së penalltive, që në fund vendosi kalimin për në çerekfinale të Kampionatit Evropian, Ronaldo mori sërish përgjegjësinë dhe në fund



mposhti Oblak. Pas golit ai u kërkoi falje tifozëve portugezë. Ai bëri me dije gjithçka pas ndeshjes dhe zyrtarizoi se po u thotë lamtumirë kampionateve evropiane këtë verë. Ronaldo konfirmoi se këto janë paraqitjet e tij të fundit në Evropian. "Ky do të jetë kampionati im i fundit evropian. Por, nuk jam i prekur nga kjo, por nga entuziazmi. Më erdhi keq për tifozët", ka thënë fillimisht Ronaldo. "Do të jap

gjithmonë maksimumin për këtë fanellë, pavarësisht nëse dështoj apo jo. Dhe unë do ta bëj këtë gjatë gjithë jetës sime, sepse ju duhet ta merrni atë përgjegjësi", përfundoi ylli portugez. Portugezët do të kenë një detyrë shumë më të vështirë në çerekfinale, pasi i pret një nga favoritet për titullin evropian, Franca, e cila dje ishte më e mirë se Belgjika, duke fituar me rezultat 1-0.

Hamiltoni merr vendimin surprizë, gati të 'zbarkojë' në Moto GP me motorin Ducati

LONDËR, 2 KORRIK - Piloti britanik i Mercedesit, Lewis Hamilton, është pranë kalimit si protagonist edhe në kampionatin e Moto GP. Shtatë herë kampioni i botës në Formula 1 ka pranuar gjithnjë se është i apasionuar pas garave të motoçiklizmit, aq sa ke vendosur të bëjë një hap të madh. Sipas medieve italiane, piloti i ardhshëm i Ferrarit është në bisedime me Gresini Racing për ta blerë "ekipin satelit" të motorit Ducati në MotoGP. Thashethemet u publikuan së fundi nga revista "The Race", sipas së cilës, Hamiltoni ka shprehur interesim për ta blerë ekipin Ducati Gresini Racing nga shefja aktuale e ekipit,



Nadia Padovani. Madje një anëtar i rrethit të ngushtë të pilotit të Formulës 1 ka deklaruar se përfaqësuesit ligjorë të Hamiltonit po vlerësojnë qëndrueshmërinë komerciale të marrjes së ekipit. Ata

kanë qenë fundjavën e fundit në Assen, ku u zhvillua gara e fundit e Moto GP, për bisedime me pronarët aktuale. Pilotët aktualë të skuadrës italiane të motoçiklizmit janë vëllezërit Marc dhe Aleix Marquez. Pak kohë më parë, pronarët e Formulës 1, Liberty Media, blenë kuotat e Moto GP, duke u bërë pronarët e rinj të kategorisë më të rëndësishme të dyrrrotakëve. Në rast se ndodh edhe kjo blerje e Ducati Gresini nga Lewis Hamiltoni, jemi pranë një momenti historik në këtë sport, me Formula 1 që shtrin gjithnjë e më shumë "kthetrat" e saj në Moto GP.

SHKURT

Rrahmani, objektivi kryesor i Bolognas

Bologna ishin padyshim surpriza më e bukur e sezonit në Serinë A ku e siguroi me meritë një biletë në grupet e Ligës së Kampionëve për sezonin e ri. Nga kjo skuadër pritet të largohet sulmuesi Joshua Zirkzee, derisa drejtuesit e klubit italian e dëshirojnë si zëvendësues anëtarin e Përfaqësueses së Kosovës, Albion Rrahmanin, i cili është pjesë e Rapid Bucureshtit në Ruman. Interesim për ish-sulmuesin e Ballkanit dhe Malishevës kanë treguar edhe Benfica dhe Werder Bremeni.

De Bruyne: Do të qëndroj te City

Kevin De Bruyne prej tetë vitesh është gurthemeli i mesfushës së Manchester Cityt, me 32-vjeçarin i cili mund të konsiderohet lehtësisht si një prej legjendave të klubit. Megjithatë, pavarësisht se ka treguar përherë besnikërinë e tij ndaj "Qytetarëve", e ardhmja e yllit të mesfushës në mediet shihet larg "Etihadit", mirëpo në një prononcim të bërë së fundmi, belgu u dha fund njëherë e mirë fjalëve që qarkullojnë, duke deklaruar se do të vazhdojë të jetë pjesë e "Qytetarëve". "Do të qëndroj te City. Kam lexuar shumë tituj lajmesh për një transferim, por unë vetë nuk kam folur me askënd. Në momentin e duhur, nëse ka një ofertë të mirë dhe i them Pep që dëshiroj të largohem është e mundur, por diçka e tillë nuk po ndodh", ka thënë De Bruyne.

Unitedi i ofron kontratë pesëvjeçare De Ligtit

Me shumë mundësi e ardhmja Matthijs de Ligt do të jetë te Manchester Unitedi. Ditët e fundit, sipas raportimeve të medieve britanike, "Djajtë e Kuq" kanë kontaktuar me përfaqësuesit e mbrojtësit të Bayern Munchenit dhe tashmë lojtari është më afër këtij transferimi, pasi ka marrë një ofertë të konsiderueshme financiare. Manchester Unitedi i ka ofruar holandezit një kontratë pesëvjeçare me terma financiare shumë tunduese.

Bellingham për golin ndaj Sllovakisë: Momenti më i bukur në karrierë

UEFA ka hapur një hetim për Jude Bellingham për shkak të gjeesteve të tij joetike pas golit të shënuar kundër Sllovakisë. Për herë të parë mesfushori i Anglisë ka reaguar në lidhje me këto gjeeste, por sigurisht preku edhe emocionet e përjetuara në momentin kur realizoi atë supergol në minutën e 95-të. "Ai ishte një nga momentet më të bukura në karrierën time deri më tani. Kur sheh tabelën që thotë edhe 6 minuta lojë, t'i kupton se mund të jenë 6 minuta e fundit të turneut. Është një ndjesi e tmerrshme. Kemi dhënë maksimumin deri në fund. Provuam në çdo formë deri në atë moment special. Kritikat? Unë mendoj se në një turne të tillë, kaq të rëndësishëm, njerëzit duhet t'i lënë pas paragjykimet e të bashkohen", u shpreh Bellinghami.

Përforcohet Philadelphia, Thompsoni lë Warriorsin

Ka nisur zyrtarisht merkatoja e basketbollit në NBA dhe që në ditën e parë nuk kanë munguar surprizat. Skuadra e Clippersit është në qendër të kësaj dite, me James Hardenin që ka rinovuar edhe për dy sezone të

tjera me skuadrën kaliforniane. Nga ky ekip është larguar Paul George, që ka firmosur me Philadelphia. Një kontratë katërvjeçare për basketbollistin 34-vjeçar, nga e cila do të përfitojë 212 milionë dollarë. Ky

transferim e bën skuadrën e Philadelphia pretendente për sezonin e ri, duke formuar një trio të frikshme me Georgen, Embiidin dhe Maxeyn. Pas një karrierë të gjatë me skuadrën e Golden State Warriorsit, ku fitoi

katër tituj kampione, largohet Klay Thompson si lojtar i lirë. Një "divorc" me mikun e tij Stephen Curry, një dyshe e njohur me nofken "splash brothers". Tashmë Thompsoni do të shohë për ofertat që do të

vijnë nga Dallasi, Lakersi, Philadelphia dhe Clippersit. Basketbollisti lituanez Jonas Valanciunas ka lënë New Orleansin për të luajtur me Washingtonin, me të cilin firmosi një kontratë trevjeçare.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare, lidhur me nenin 27.3 të Rregullores (ZKA) 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2024 si dhe Vendimit të Auditorit të Përgjithshëm me Nr.1018 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit rishpall:

KONKURS për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita:	Auditor junior për auditim të performancës
Numri i referencës:	RAJAP/ZKA/05-06/24
Grada:	ZKA-A8
Numri i pozitave:	Dy (2)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen auditime sipas planit vjetor, rregullave dhe metodologjisë së ZKA-së, Kodit të Etikës dhe në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe raporton Drejtorit të Departamentit të Auditimit dhe udhëheqësit të ekipit të auditimit;
- Kryen hulumtime dhe analizë për fushën të caktuar dhe bën propozimin e temave audituese për planifikimin strategjik dhe atë vjetor të ZKA-së;(nën mbikëqyrje nga UA);
- Pjesëmarrje aktive në parastudim të auditimit në fusha të caktuara dhe deleguara nga UE;
- Ofron përkrahje profesionale duke kryer hulumtime dhe analiza të të dhënave të mbledhura dhe prezantimin e tyre;
- Mbajtja e shënimeve dhe dokumentimi i intervistimit dhe gjetjeve tjera;
- Nxjerrja konkluzioneve dhe dhënia e rekomandimeve duke u mbështetur në dëshmitë audituese dhe në bazë të gjykimit profesional;
- Përgatitja e Letrave të punës me kohë së bashku me dëshmitë përkatëse dhe memo përmbledhës lidhur me auditimin e komponentës, fushës apo pyetjeve audituese, e cila i është caktuar;
- Indeksi i letrave të punës dhe diskutimi me Udhëheqësin e tij/saj;
- Raportimi i vazhdueshëm të mbikëqyrësi lidhur me progresin e arritur në auditim;
- Aplikimi i punës online sipas kërkesave dhe udhëzimeve në nivel të zyrës për situata të caktuara;
- Kryen edhe detyra të tjera profesionale të kërkuara nga UEA dhe nga Drejtori i departamentit.

Kualifikimet Themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale në hulumtim apo analiza, preferohet përvojë në auditim;
- Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

Shkathësitë e kërkuara:

- Njohuri në fushën e auditimeve;
- Shkathësi në organizim të punës dhe përmbyllje të objektivave;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Njohuri për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi motivuese, dhe komunikuese në ekip;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

Informata të përgjithshme për kandidatët:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomati e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **18.07.2024 ora 16.00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë punë nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

